



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada-Government*

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural  
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja  
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development  
*Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/Agencija za Razvoj Poloprivrede/ Agriculture Development Agency*

DIVIZIONI PËR KOMUNIKIM ME PUBLIKUN/DIVIZIE ZA JAVNO KOMUNICIRANJE/  
/DIVISION OF PUBLIC COMMUNICATION/

**THIRRJE PËR APLIKIM**  
**PËR GRUPET LOKALE TË VEPRIMIT POTENCIALE DHE PËR RRJETIN PËR ZHVILLIMIN RURAL TË GLV-VE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**  
PËR PËRFITIM NË KUADËR TË IMPLEMENTIMIT TË “PLANIT PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL 2014-2020”, MASA 303.1, “PËRVETËSIMI I AFTËSIVE DHE FRYMËZIMI/NXITJA E BANORËVE TË ZONAVE RURALE PËR GLV POTENCIALE DHE PËR RRJETIN PËR ZHVILLIMIN RURAL TË GLV-VE”

### **Qëllimi i thirrjes për aplikim**

Qëllimi i thirrjes për aplikim është dhënia e mbështetjes financiare/granteve për ngritjen e kapaciteteve të GLV-ve potenciale, si dhe të RrZhR-ve të GLV-ve, në kuadër të Masës 303.1 “Përvetësimi i aftësive dhe frymëzimi/nxitja e banorëve të territoreve rurale për GLV potenciale si dhe asistencë teknike për Rrjetin për Zhvillimin Rural” sipas “Planit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural 2014-2020”

### **Përfituesit e pranueshëm**

Përfituesit e pranueshëm për këtë masë janë të gjitha GLV-të potenciale si dhe RrZhR-të e Republikës së Kosovës. Për të qenë përfitues të mundshëm të kësaj mase, duhet të përmbushen edhe kushtet e përcaktuara në këtë thirrje për.

### **1. Shtrirja gjeografike**

Tërë territori i Republikës së Kosovës

### **2. Kriteret e pranueshmërisë që duhet të plotësojnë GLV-t potenciale në mënyrë që të jenë përfitues të mundshëm:**

- Duhet të jetë koherent në kuptimin gjeografik (një njësi homogjene);
- Numri i banorëve të zonës/territorit ku vepron një GLV potenciale nuk mund të jetë më i vogël se 10.000 banorë dhe nuk mund të tejkalon numrin prej 150.000 banorëve;
- Mund të përfshihen edhe vendbanimet rurale, qytete të vogla më pak se 30.000 banorë;

- Territori/zona e GLV-së duhet të jetë pjesë përbërëse nga pikëpamja ekonomike, sociale dhe fizike (gjeografike) dhe nuk duhet t'i përket territorit të GLV-së tjetër. Të mos ketë mbivendosje/përputhje në mes GLV-ve.
- Të prezantohet partneriteti publiko privat.

### 3. Dokumentet që duhet të dorëzohen nga RrZhR:

- Certifikatën e regjistrimit të Rrjetit;
- Historiku i RrZhR-së, aktivitetet e realizuara;
- Dëshmia e kryerjes së obligimeve të anëtarësisë ndaj RrZhR-së;
- Kopje e letërnjoftimit të përfaqësuesit të autorizuar nga RrZhR-të;
- Dëshminë e xhirollogarisë bankare në emër të përfaqësuesit të RrZhR-së;
- Certifikatën e numrit fiskal të RrZhR-së.

### 4. Investimet e pranueshme për GLV-të potenciale dhe RrZhR të GLV-ve.

#### A. Punëtori dhe ngjarje informative për nxitjen e pjesëmarrjes aktive të popullsisë rurale në procesin e zhvillimit lokal

- Shërbimet e ekspertëve;
- Përkthimi i dokumenteve dhe interpretimit;
- Qeraja e objekteve dhe pajisjeve;
- Qeraja e sallës për ngjarje;
- Furnizim me ushqim për pjesëmarrësit;
- Tarifat, kostot e regjistrimit;
- Blerja e materialeve;
- Shpenzimet e udhëtimit.

#### B. Trajnimi dhe përvetësimi i aftësive të stafit/ekipit të përfshirë në përgatitjen e strategjisë zhvillimore lokale

- Shërbimet e ekspertëve;
- Përkthimi i dokumenteve dhe interpretimit;
- Qeraja e objekteve dhe pajisjeve;
- Furnizimi me ushqim për pjesëmarrësit;
- Blerja e materialeve.

#### C. Trajnimi i udhëheqësve informal/multiplikatorë dhe menaxherëve për të ardhmen e GLV-së

- Shërbimet e ekspertëve;
- Përkthimi i dokumenteve dhe interpretimit;
- Qeraja e objekteve dhe pajisjeve;
- Furnizim me ushqim për pjesëmarrësit;
- Blerja e materialeve.

#### D. Organizimi i trajnimeve tjera të nevojshme për përgatitjen / implementimin e strategjive zhvillimore lokale

- Shërbimet e ekspertëve;
- Përkthimi i dokumenteve dhe interpretimit;

- Qeraja e objekteve dhe pajisjeve;
- Furnizim me ushqim për pjesëmarrësit;
- Qeraja e sallës për ngjarje.

E. Përgatitja /përpunimi dhe shpërndarja e materialeve informuese të nevojshme për përgatitjen dhe publicitetin e strategjive lokale të zhvillimit (duke përfshirë faqet e internetit, broshura etj.)

- Shërbimet e ekspertëve;
- Përkthimi i dokumenteve dhe interpretimit;
- Qeraja e pajisjeve;
- Abonimet për publikime;
- Përkthimi i publikimeve;
- Blerja e materialeve;
- Publiciteti, publikimet, broshurat, fletëpalosjet;
- Krijimi i faqes në internet.

F. Analizat territoriale dhe socio-ekonomike, studime të zonës rurale në fjalë me qëllim të përgatitjes së një strategjie zhvillimore lokale

- Shërbimet e ekspertëve
- Përkthimi i dokumenteve dhe interpretimit;
- Abonimet për publikime;
- Përkthimi i publikimeve;
- Blerja e materialeve.

## Dokumentet e bashkëngjitura

### a. Për GLV-të potenciale

Dokumentet e bashkëngjitura /ju lutem shënoni më * /✓/ (dhe radhitni ato sipas listës së dhënë në fund të këtij aplikacioni	Obligative
1. Formularin për Aplikim - sipas modelit, preferohet të jetë i plotësuar me makinë ose kompjuter	<input type="checkbox"/>
2. Aplikuesi/GLV-potencial duhet të paraqesë një projekt propozim sipas modelit të prezantuar në udhëzues	<input type="checkbox"/>
3. Dëshminë se menaxheri (udhëheqësi i GLV-së potenciale ka eksperiencë në zhvillim rural/ Diploma e fakultetit dhe CV	
4. Dëshminë se trupi menaxhues i GLV-së potenciale prezanton interesat e grupeve të ndryshme publike dhe private (lista e anëtarëve të trupit menaxhues)	<input type="checkbox"/>
5. Mbi 50% të anëtarëve duhet të jenë paraqesin partneret ekonomik, social, shoqërorë civile, asociacione, shoqata të ndryshme që mbulojnë atë territor (lista e anëtarëve)	<input type="checkbox"/>
6. Jo më pak se 20% të jenë anëtarë që vijnë nga institucionet publike (lista e anëtarëve)	<input type="checkbox"/>
7. Respektimi i diversitetit të moshës dhe barazia gjinore më së paku 10 % të anëtarëve të jenë femra dhe të rinj (lista e anëtarëve)	<input type="checkbox"/>
8. Certifikatën e regjistrimit të GLV-së potenciale në Regjistrin e OJQ-ve, në Ministrinë e Administratës Publike	<input type="checkbox"/>
9. Kopje e letërnjoftimit të përfaqësuesit të autorizuar nga GLV-ja potenciale	<input type="checkbox"/>
10. Dëshminë e xhirollogarisë bankare në emër të përfaqësuesit të GLV-	<input type="checkbox"/>

së potenciale	
11. Certifikatën e numrit fiskal të GLV-së potenciale	<input type="checkbox"/>
12. Dëshminë nga zona/territori ku vepron një GLV (komuna), numrin e banorëve që përfshin një GLV- potenciale ( nuk mund të jetë më i vogël se 10.000 banorë dhe nuk mund të tejkalojë numrin prej 150.000 banorëve duke përfshirë qytete të vogla më pak se 30.000 banorë)	<input type="checkbox"/>

### Dokumentet e bashkëngjitura për Rrjetin e Zhvillimit Rural të GLV-ve

Dokumentet e bashkëngjitura /ju lutem shënoni më ✖ /✓ (dhe radhitni ato sipas listës së dhënë në fund të këtij aplikacioni	Obligative
1. Formularin për Aplikim - sipas modelit, preferohet të jetë i plotësuar me makinë ose kompjuter	<input type="checkbox"/>
2. Aplikuesi/RrZhr duhet të paraqesë një projekt propozim sipas modelit të prezantuar në udhëzues	<input type="checkbox"/>
3. Certifikatën e regjistrimit të RrZhr-së në Regjistrin e OJQ-ve, në Ministrinë e Administratës Publike	<input type="checkbox"/>
4. Kopje e letërnjoftimit të përfaqësuesit të autorizuar nga RrZhr-ja	<input type="checkbox"/>
5. Dëshminë e xhirollogarisë bankare në emër të përfaqësuesit të RrZhr-së	<input type="checkbox"/>
6. Certifikatën e numrit fiskal të RrZhr-së	<input type="checkbox"/>
7. Dëshmia e kryerjes së obligimeve të anëtarësisë ndaj RrZhr-së	<input type="checkbox"/>

### Shkalla e përkrahjes

Shkalla e përkrahjes për Masën 303.1 “Përvetësimi i aftësive dhe frymëzimi/nxitja e banorëve të territoreve rurale për GLV-të potenciale, si dhe asistencë teknike për Rrjetin për Zhvillimin Rural” është 100%.

### Koha dhe mënyra e pranimit të aplikacioneve

- Data e fillimit të dorëzimit të formularit për aplikim është dita pasi të jetë e publikuar thirrja për aplikim;
- Thirrja për aplikim do të jetë e hapur 30 ditë për GLV-të potenciale si dhe për RrZhr të GLV-ve.
- Formulari për aplikim dhe dokumentacionet e bashkëngjitura duhet të dorëzohen në Zyret e Autoritetet Menaxhues në MBPZHR, adresa Nëna Tereza 35 Zyra nr. 213, te zyrarja Lindita Dragusha. Nga ora 10:00 -12:00 dhe 13:00 – 15:00 çdo ditë pune.

Për informata më të hollësishme vizitoni web faqen: [www.azhb.rks-gov.net](http://www.azhb.rks-gov.net)

[www.mbpzhr-gov.net](http://www.mbpzhr-gov.net), si dhe udhëzuesin për aplikues.